



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KURBIN
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 853/Prot.
2

Laç më 29.2.2024

VENDIM

Nr. 18 .Datë 23.02.2024

“PËR NGRITJEN KOMISIONIT TË STREHIMIT SOCIAL”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 24, nenit 54 shkronja “k” nenit 55 pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, në nenin 2 pika 51 dhe nenit 15 pika 5, të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social” i ndryshuar; VKM nr.384 datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo program social të strehimit dhe te afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, VKM nr.362, datë 29.5.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, VKM nr. 453, datë 3.7.2019 “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti”, VKM-së nr.405, datë 01.06.2016 “Për miratimin e strategjisë të strehimit social 2016-2025” pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Strehimi Social, pas propozimit nga Kryetari i Bashkisë dhe komisioni i Strehimit, Këshilli Bashkiak ;

VENDOSI;

Të miratojë Komisionin e Strehimit Social

1. Pranë Bashkisë Kurbin ngrihet dhe funksionon Komisioni i Strehimit.
2. Komisioni i Strehimit shqyrton dhe merr vendime në lidhje me kërkesat e paraqitura nga çdo subjekt që kërkon për të përfituar nga njëri prej programeve sociale të strehimit, si dhe çdo çështje tjetër që parashikohet nga legjislacioni për strehimin apo akteve të tjera ligjore dhe nënligjore që përcaktojnë shqyrtimin e kërkesave nga ky komision.
3. Komisioni i Strehimit përbëhet nga 7 anëtarë, si më poshtë:

a. Zëvendës Kryetar i Bashkisë	Kryetar
b. Drejtori i Shërbimeve publike	Zv. Kryetar
c. Përfaqësues nga Drejtoria Juridike	Anëtar
d. Përfaqësues nga Drejtoria e Financës	Anëtar
e. Përfaqësues nga D.P.Zh.K.T	Anëtar
f. Përfaqësues nga D.Nd. Ekon dhe Kuj.Social	Anëtar
g. Përfaqësues i Komunitetit te Interesuara	Anëtar
4. Komisioni i Strehimit asistohet nga një sekretariat administrativ, i cili asiston komisionin gjatë gjithë

veprimtarisë së tij. Anëtarët e sekretariatit janë pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe janë përgjegjës për:

- a. Marrjen në dorëzim të aplikimeve dhe kërkesave që janë objekt i shqyrtimit dhe vendimmarrjes së Komisionit;
- b. Shpërndan dhe vë në dispozicion të anëtarëve materialet për mbledhjen e radhës. Mban, harton dhe nënshkruan procesverbalin e mbledhjes;
- d. Zbardh vendimin e arsyetuar të marrë në mbledhjen e Komisionit i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët prezent;
- e. Ruan konfidencialitetin

5. Ngarkohen Komisioni i Strehimit, Zëvendës Kryetar i Bashkisë, Drejtorja e Shërbimeve Publike, Drejtorja Juridike, Drejtorja e Financës, Drejtorja e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit dhe Drejtorja e Ndihmës Ekonomike dhe Kujdesit Social për zbatimin e këtij urdhëri.

Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë .

>Prefektit Të Qarkut Lezhë

>Drejtorja e Shërbimeve Publike

>Arkivi

Sekretari i Këshillit

Arber Leka



Kryetare e Këshillit

Edlira Lleshi

